

Besimi në politikë

Përceptimi për përfaqësimin në Kosovë 2012-2023



Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

Besimi në politikë

Përceptimi për përfaqësimin në Kosovë 2012-2023

Prishtinë, dhjetor 2023.

Të drejtat e autorit © 2023. Demokracia për Zhvillim (D4D)

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pasazheve të shkurtra me qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të D4D.

Përgatitur nga:

Demokrati për zhvillim

Ky punim është përgatitur me mbështetjen e projektit rajonal “SMART Balkans – Shoqëria civile për vlera të përbashkëta në Ballkanin Perëndimor” të zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD), Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA).

Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Institutit D4D dhe jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e partnerëve të projektit dhe donatorit NMFA.

Përmbajtja

Përmbledhje	4
<i>Rekomandime</i>	<i>7</i>
Mbi serinë e trendeve dhe të anketave	8
Hyrje	11
<i>Metodologjia e anketës</i>	<i>11</i>
<i>Pasqyrë e zgjedhjeve nga 2000 deri 2023</i>	<i>13</i>
1. Marrëdhënia me politikën	15
1.1. <i>Takimet me të zgjedhur</i>	<i>15</i>
1.2. <i>Afërsia</i>	<i>16</i>
2. Sjellja e votuesve	23
2.1. <i>Dalja në zgjedhje këtë të dielë</i>	<i>24</i>
2.2. <i>Arsyet për për zgjedhjen e partisë</i>	<i>27</i>
2.3. <i>Përzgjedhja e kandidatëve</i>	<i>33</i>
2.4. <i>Burimi i informacionit</i>	<i>39</i>
3. Trendet e votimit	45
3.1. <i>Për kë do të votoje po të mbaheshin zgjedhjet këtë dielë?</i>	<i>45</i>
3.2. <i>Nga viti 2021 deri më 2023?</i>	<i>51</i>
3.3. <i>Preferenca e dytë</i>	<i>55</i>

Përmbledhje

Afërsia e qytetarëve me politikën ka shënuar nivelin më të ulët në vitin 2016. Beteja politike ishte e ashpër dhe qytetari nuk i besonte më partive në rënie por akoma nuk i kishte dhënë besimin Vetëvendosjes në rritje e sipër. Sivjet ka rënie të lehtë krahasuar me vitin 2019.

Votuesit urban, gratë, të rinjtë e të papunët që nuk janë duke kërkuar punë, dhe votuesit me të ardhura mbi mesatare ndjehen më pak të afërt me politikën. Ndoshta Kosova nuk është aq klienteliste sa është krijuar përceptimi, duke pasur parasysh se anketa ka nxjerrë që kategoria më e politizuar janë të punësuarit në sektorin privat. Nëntë nga dhjetë ithtarë të AAK-së ndihen shumë të afërt, shifra më e lartë nga të gjitha partitë politike (PDK 71%, VV 67% dhe LDK 56%).

Është lajm i mirë që ka rënie të militantëve partiak si dhe ka rënie të numrit të qytetarëve që nuk ndjehen të afërt me asnjë parti. Politika është bërë më e personalizuar dhe më pak me çështjet dhe programin, gjë që është një trend negativ.

Krahasuar me vitin 2012, më shumë votues sot e zgjedhin partinë e tyre të preferuar bazuar në afinitetin e tyre për liderët dhe më pak për shkak të interesit kombëtar. Rritja e Vetëvendosjes duket ka rritur shkallën e respondentëve që zgjedhin partinë për shkak të liderit (34% në vitin 2023, krahasuar me 27%, njëmbëdhjetë vjet më parë).

Më pak kosovarë vlerësojnë cilësinë e programit të partisë si të rëndësishme kundrejt numrit të respondentëve që e vlerësojnë cilësinë e ekipit, listën e kandidatëve apo përfaqësimin rajonal.

Në ditën e anketës (qershor 2023), 58% të respondentëve u deklaruan se gjithsesi do të votonin dhe trendi ishte më i lartë

tek burrat (2/3) sesa tek gratë (gjysma) edhe pse pjesa e mbetur e grave u deklaruan se do të votonin por nuk ishin të sigurt. Votuesit nga zonat rurale deklarohen më të gatshëm për të votuar ashtu si edhe të moshuarit.

Grup-mosha më e re duket të jetë më patriotikja (votimi në interes të Kosovës), grup mosha 25-34 vjeç kanë interes për cilësinë e programit, responentët e moshës së mesme vlerësojnë cilësinë e ekipit, ndërsa të moshuarit e shohin udhëheqësin si më të rëndësishmin. Votuesit që kanë arsimim më të lartë vlerësojnë përfaqësimin rajonal.

Shumica e votuesve të LVV dhe AAK kanë përzgjedhur subjektin e tyre për shkak të liderit. Votuesit e PDK mbështesin subjektin e tyre për shkak të cilësisë së ekipit përderisa LDK-ja përzgjedhet për shkak të cilësisë së programit. AAK-së dhe PDK-së u besohet më tepër nga ata që dëshirojnë që rajoni i tyre të përfaqësohet përderisa LVV dhe LDK kanë mbështetje më të shpërndarë.

Ka rënie të mbështetjes për kandidatë të dëshmuar profesionalisht. Në vitin 2012, 23% të qytetarëve kishin deklaruar se shpejtë e shpejtë kanë përzgjedhur 5 emra në fletëvotim – kjo ka rënë dukshëm që shënon përmirësim dhe kujdes më të madh në përzgjedhje. Votuesit urban kërkojnë dëshmi profesionale përderisa votuesit rural favorizojnë që kandidatët nga vendbanimi i tyre.

Solidariteti mes grave ishte shkas prapa zgjedhjes për çdo të pestën grua. Gratë ndjehen më pak të afërta me ndonjë subjekt. Dy të pestat (2/5) e grave votojnë për gjininë e njëjtë dhe më pak e respektojnë sugjerimin e liderit për kandidatët sesa meshkujt. Kjo i bën gratë më interesante për t'u targetuar nga partitë që dëshirojnë të rrisin elektoratin e tyre.

Të dhënat tregojnë një ndryshim sa i përket mënyrës së informimit të kosovarëve. Për herë të parë, televizionit i ka

rënë rëndësia si burim i informacionit dhe kosovarët informohen më shumë nga interneti sesa nga televizioni, veçanërisht të rinjtë, të arsimuarit, votuesit me të ardhura mbi mesatare dhe popullata urbane. Ata që informohen nga televizioni janë edhe votues që votojnë më tepër nga motivi për liderë.

VV ka ruajtur primatin me mbështetje më të madhe nga votuesit urban dhe të arsimuar (që vlen edhe për LDK) përderisa PDK dhe AAK gëzojnë më tepër mbështetje në zona rurale.

Shumica e votuesve të LVV, si subjekt të dytin kanë LDK-në (43%) dhe vlen trendi anasjelltas. Afërsia e profilit të votuesve i bën këto dy parti edhe rivale kryesore. Për shkak që peshkojnë në mesin e votuesve të të njëjtit profil, ngritja e njëjës domosdo rezulton në rënien e tjetrës. LDK është gjithashtu opsioni i dytë edhe për 27% të votuesve të PDK të cilët si opsion të tretë kanë AAK (22%), tjerët (19% dhe LVV (15%).

Rekomandime

LDK dhe PDK duhet të investojnë më shumë në paraqitje të lidërshiptit përderisa AAK dhe LVV duhet të investojnë më tepër në ekip dhe në pozicione programore.

Opozita duhet të targetojë të rinjtë sepse nuk e kanë votën e përkushtuar për një subjekt të caktuar. Trendi i ulët i votimit të tyre i bën ata cak potencial për rritje por duhet gjetur shkas të fuqishëm për t'i motivuar ata të votojnë në ditën e zgjedhjeve.

Kriteret dhe arsyet për përzgjedhje të kandidatëve duhet të analizohen mirë nga partitë gjatë procesit të përpilimit të listave. Çdo parti duhet zhvillojë anketa dhe fokus grupe për nevoja të veta elektorale për të testuar më detajisht dhe imazhin dhe besimin e qytetarëve vet tek subjekti dhe kandidatët.

Fakti se interneti çon peshë më shumë është lajm i mirë për partitë me mjete modeste sepse barazon garën për subjektet që kanë ide dhe më pak resurse për fushatë. Sfidë mund të paraqesin votuesit e moshuar të cilët mund të ndjehen më pak të përfaqësuar me lëvizje të debatit online.

Ka kohë që nuk funksionon fushata e bazuar vetëm në kriter gjeografik. Partitë që dëshirojnë të rrisin mbështetjen duhet të zhvillojnë programe për kategori të ndryshme demografike duke segmentuar elektoratin për gjini, moshë, interesa, etj. dhe të zgjedhin mënyrat më racionale për të depërtuar tek ta.

Mbi serinë e trendeve dhe të anketave

Gjatë dy dekadave të fundit - që nga lufta dhe shpallja e pavarësisë – Kosova ka kaluar me sukses sfidat e hershme të transicionit, vazhdimisht ka ndërruar qeveritë dhe e ka çrënjosur mashtrimin zgjedhor.

D4D angazhohet që ta bëjë politikën më pak emocionale dhe për karizëm individuale dhe më racionale dhe ndërlidhur për politikat publike. D4D vazhdimisht ka kontribuar hulumtimit dhe diskutimeve zgjedhore për të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zgjedhjet me programe, të organizuara rreth gjashtë shtyllave kryesore:

Sistemi i zgjedhjeve:

1. Mashtrimi zgjedhor dhe drejtësia;
2. Monitorimi i zgjedhjeve dhe procesi zgjedhor;
3. Trendet zgjedhore (anketimet dhe të dhënat statistikore);
4. Harta ideologjike; dhe
5. Përfaqësimi i grupeve të nën-përfaqësuara: të rinjtë dhe gratë.



Ky publikim është pjesë e trendeve (pika 4 më lart) siç paraqesin kopertinat e publikimeve të mëparshme. D4D ka përcjellë dy lloje trendesh, ato që monitorojnë çështjet që krahasojnë të dhënat e zgjedhjeve në intervale të caktuara kohore dhe ato që maten përmes anketave të opinionit publik.



Botimet e D4D janë të natyrës kërkimore, por me rezultate dhe ndikim real në përvojën e Kosovës me demokracinë. Në njërën nga publikimet e para, D4D kishte vënë në pah trendin se norma me të cilën votojnë gratë është për 1/3 krahasuar me burrat. Dëshmitë tona të tjera treguan po ashtu se partitë po përqendroheshin vetëm në mbajtjen e votuesve të tyre aktual dhe pak u kushtonin vëmendje ndryshimeve të shpejta

demografike. Disa parti i morën parasysh gjetjet dhe u kushtuan më shumë vëmendje këtyre grupeve, duke e rritur kështu me shpejtësi mbështetjen për ta.

Përmes të dhënave dhe vëzhgimit, D4D identifikoi një nga burimet kryesore të mashtrimit – marrëveshjen e orkestruar të dy partive për të kontrolluar zyrtarin që kontrollon letërnjoftimin në çdo vendvotim. Kjo rezultoi në kërkesën tonë që vëzhguesit të vendosen mbrapa zyrtarëve të vendvotimit, një moment kyç ky i cili filloi përmbysjen trendin të mashtrimit.

Në përgjithësi, puna jonë mbi trendet (anketimet dhe statistikat faktike) që ne mëtojmë të vazhdojmë ka kontribuar në:

- > cilësinë e demokracisë;



- › cilësinë dhe problemet e dinamikës dhe të demokracisë brenda-partiake;
- › monitorimin e efekteve të listave të hapura dhe evidentimin e nevojave për ndryshime të mëtejshme të sistemit zgjedhor;
- › monitorimin e ecurisë së zgjedhjes së grave (sipas meritës dhe kuotave);
- › evidentimin e trendeve që nuk shihen me sy të lirë dhe që zbulohen vetëm nga të dhënat (p.sh. gabimet në disa komuna ku numri i fletëvotimeve të pavlefshme ishte shumë më i madh se mesatarja kombëtare).

Vazhdimi i publikimit të trendeve zgjedhore ka treguar se mundëson shqyrtimin e çështjeve potenciale, pa kërkuar mbulim të gjerë me vëzhgues, duke ulur kështu me të madhe koston.

Me këtë publikim vazhdohen përpjekjet për të nxitur rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve dhe të grave duke trajtuar ngecjen e vazhdueshme prej 10-15% pas mesatares, rritjen e votimit për kandidatë të rinj, si dhe duke siguruar përfshirjen e të moshuarve, pasi dimensionin digjital bëhet gjithnjë më mbizotërues.

Hyrje

Nga viti 2012, D4D përsërit një numër pyetjesh në anketë publike dhe këtë herë publikon trendet e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes deri më 2023. Kjo anketë del disa muaj pas përfundimit ashtu që t'i ikë politizimit – mos të ndikojë në disponimin votues por të analizojë shkaktarët e disponimit. Pyeja “për kë do të votoje” nuk bëhet me qëllim që të krijohet lajm por për të bërë kros-tabulime të shumta për të kuptuar dinamikën e shkaqeve dhe nuancave që ndikojnë në përfaqësim më cilësor.

Kapitujt nga 1 deri në 3 përmbledhin tri temat kryesore të organizuara sipas nën-temave që përkojnë me pyetjet specifike të parashtruara në anketë.

Lexim të këndshëm!

Metodologjia e anketës

D4D rregullisht angazhon kompaninë për matje të opinionit publik, UBO Consulting për të realizuar anketat për nevoja të saj. Si pjesë të anketës omnibus, D4D parashtron disa pyetje të cilat me metodologji të njëjtë janë realizuar vite me radhë.

Anketa realizohet në të gjitha komunat në Kosovë, duke përdorur metodën e mostrës të rastit të shtresuar. Mostra e rastit shtresohet në tri grupe: në bazë të përkatësisë etnike, në bazë të banimit, ku për çdo komunë mostra shpërndahet në pjesët rurale/urbane, sipas statistikave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Shtresimi i tretë bëhet sipas numrit të anketave të realizuara në çdo vendbanim.

Kjo anketë është realizuar gjatë gjysmës së parë të qershorit dhe ka nivel të konfidencës prej 95% dhe margjinë të gabimit prej $\pm 3\%$. Janë anketuar 1,065 qytetarëve të moshës mbi 18

vjet: 815 shqiptarë, 150 serbë dhe 100 pjesëtarë të komuniteteve tjera. Mostra pastaj është peshuar që të pasqyrojë trendet për strukturën etnike të Kosovës.

Mostra është përzgjedhur duke anketuar shtëpinë e tretë duke ecur në anën e majtë të rrugës dhe metodë e ngjashme përdoret për përzgjedhjen e personave mbi 18 vjeç për intervistë. Kontrolli i cilësisë bëhet duke verifikuar 30% të respodentëve sipas metodave standarde.

Me qëllim që të ulim margjinën e gabimit dhe të sigurohemi që lexuesit mund të citojnë vetëm të dhënat në të cilat statistikisht mund të mbështetemi, kemi grupuar trendet sipas disa kategorive.

Ndarjet kryesore demografike të anketës janë gjinia (Burra 49.6%/Gra 50.4%), banimi (Urban 44.4%/Rural 55.6%) dhe mosha, 18-24 (20.2%), 25-34 (23.7%), 35-44 (20.3%), 45-54 (15.3%) dhe 55+ (20.5%).

Sa i përket nivelit të arsimit, respodentët janë përgjigjur me numrin e viteve sa shkollë kanë përfunduar. Sa i përket prezantimit të të dhënave, mostra është ndarë në tri kategori përafërsisht të barabarta: me më pak arsim sesa shkolla e mesme (<mesme, 22.1%), me shkollë të mesme (49.6%), dhe me më shumë se shkollë të mesme (>mesme, 28.3%).

Sa i përket të ardhura, respondentët janë ndarë në dy kategori duke ndarë në ata me më pak se 300 Euro (<300, 58.8%) dhe me më shumë se 300 Euro (301+, 31.4%).

Është më lehtë të interpretohen trendet për vitet paraprake nëse lexuesi mund që të verifikojë nëse ai vit ka qenë vit zgjedhor apo jo. Prandaj pjesa më poshtë paraqet një pasqyrë të gjitha zgjedhjeve të mbajtura në Kosovë përfshirë datat e mbajtjes.

Pasqyrë e zgjedhjeve nga 2000 deri 2023

Historia demokratike e Kosovës së pasluftës tashmë numëron 20 palë zgjedhesh: 8 palë zgjedhje nacionale, 7 palë zgjedhje për kuvendet komunale dhe 5 palë zgjedhje për kryetarë komunash. Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat për të gjitha zgjedhjet në Kosovë që nga viti 2000, kur Kosova organizoi zgjedhjet e para kur ende ishte nën mbikqyrjen ndërkombëtare.

Viti	Zgjedhjet për..			Anketa
	Parlament	Kuvende K.	Kryetar K.	
2000		28-tet-00		
2001	17-Nen-01			
2002		26-Tet-02		
2003				
2004	23-Tet-04			
2005				
2006				
2007		17-Nen-07		
2008				
2009		15-Nen-09		
2010	12-Dhj-10			
2011				
2012				<i>Tet-12</i>
2013		3-nën-13		
2014	8-qer-14			<i>Qer-14</i>
2015				<i>Mar-Nen-15</i>
2016				<i>Shk-Dhj-16</i>
2017	11-qer-17	22-tet-17		<i>Mar-Sht-17</i>
2018				<i>Qer-18</i>
2019	6-Tet-19			<i>Mar-19</i>
2020				
2021	14-Tet-21	17-Tet-21		<i>Sht-21</i>
2022				<i>Mar-Dhj-22</i>
2023				<i>Mar-Qer-23</i>


1. Marrëdhënia me politikën

Të qenit aktiv në politikë është një nga matësit sa është i shëndetshëm besimi i qytetarit tek të zgjedhurit dhe sa funksionon llogaridhënia. D4D rregullisht ka shtruar këtë pyetje në anketa dhe tani kemi një trend kohor të gjatë që mat këtë dukuri me dy pyetje: (1.1) takimet me të zgjedhur në 12 muajt e fundit dhe (1.2) afërsia me partinë.

1.1. Takimet me të zgjedhur

Anketa më poshtë paraqet trendin sa raportojnë qytetarët nëse kanë takuar një kryetar komune, këshilltar komunal apo deputet në 12 muajt e fundit. Viti 2014 ishte viti kur politikanët më së shumti takonin qytetarët, mbase ishte periudhë e një gare të ashpër mes rivalëve politik. Anketa u realizua pikërisht gjatë periudhës zgjedhore pak muaj pasi që ishin mbajtur zgjedhjet lokale në fund të 2013. Edhe viti 2018 paraqet një ngritje mbase u realizua pak muaj pas mbajtjes së tri palë zgjedhje në fund të 2017.

Në 12 muajt e fundit kam kontaktuar me..



Është normale që qytetari takon më tepër këshilltarët komunal sepse janë më afër në aspektin gjeografik si dhe janë më shumë në numër (mbi 1000 këshilltarë komunal në tërë Kosovën). Është brengosës fakti që ka vazhduar rënia e takimeve me deputetë dhe se nuk është ngritur trendi i takimit të kryetarëve të komunës.


1.2. Afërsia

Nga viti 2012, D4D mat afërsinë e qytetarëve me politikën duke bërë pyetjen se sa afër ndjehen me partinë të cilën e mbështesin. Niveli më i ulët është shënuar më 2016 por edhe sivjet ka rënie të lehtë krahasuar me vitin 2019. Mbase është përmirësim që ka më pak militantë por edhe përqindja e qytetarëve që nuk ndjehen aspak të afërt me asnjë parti ka rënë.


Nuk ka nivel ideal për këto vlera por është e qartë se është mirë të kemi më pak qytetarë që ndjehen larg politikës apo që ndjehen fansa militant të një partie. Me këtë kriter, mbase viti 2014 do të ishte më afër ideale.

Viti 2016 ishte viti kur u zhvillua betejë e ashpër mes Vetëvendosjes në ngritje (që ende nuk kishte krijuar një bazë stabile të votuesve) dhe partive kryesore të asaj kohe (të bashkuara rreth emërtimit PAN) besimi drejt të cilave kishte filluar të bie.

Sa të afërt ndiheni me partinë që e përkrahni/votoni?




Afërsia me partinë (2023, sipas gjinisë)



Gratë prirjen të jenë më dyshuese ndaj partive politike sesa burrat. Burrat e tejkalojnë numrin e grave me 12% sa i përket ndjenjës së afërsisë me një parti politike. Votuesit rural prirjen të ndihen më të afërt me partitë politike (68%) sesa votuesit urban (62%), edhe pse dallimi është më i ulët se ai mes burrave dhe grave.

Afërsia me partinë (2023, sipas nivelit të edukimit)




Mosha e shtyrë ndjehet më e afërt me partinë e vet dhe shkalla më e ulët është e moshës së mesme (45-54 vjeçare).

Trendi për nga arsimimi është po ashtu i butë, ku ata me arsim mesatar (shkollë të mesme) tregojnë se ndjehen më të afërt me partitë politike sesa respondentët me më shumë ose me më pak arsim. Trendi duket i njëjtë edhe pse arsyet me gjasë mund të jenë të ndryshme, sepse të arsimuarit janë më kritikë dhe me gjasë edhe votues për kauzë dhe jo të përkushtuar për emra, përderisa ata me arsim të ulët mund të ndjehen të papërfshirë.

Ndoshta treguesi më i dukshëm në një kulturë politike klienteliste është të krahasohet tabela e afërsisë me një parti politike me statusin e tyre të punësimit. Respondentët me të ardhura më të larta sesa mesatarja ndjehen më pak të afërt me partinë e preferuar të tyre, ndërsa ata me të ardhura më të ulëta, ndjehen më të afërt.


Afërsia me partinë (2023, sipas të të ardhurave)



Amviset, të rinjtë dhe respondentët e papunë që nuk kërkojnë punë, ndjehen më pak të afërt me ndonjë parti, ashtu sikurse të rinjtë. Respondentët që janë në kërkim të një pune ose që janë të punësuar në sektorin publik tregojnë afërsi më të

madhe me partitë politike. Ndoshta Kosova nuk është aq klienteliste sa është krijuar perceptimi në popull, sepse befasisht del që punonjësit në sektorin privat janë më të politizuar.

Afërsia me partinë (2023, sipas punësimit)




Nëse do të diskutohet për zgjedhjet në të ardhmen e afërt, grafiku i mëposhtëm mund të jetë një nga më të rëndësishmit për partitë politike. Respondentët që shfaqin afërsi me AAK-në tregojnë gatishmërinë më të lartë për të votuar nëse zgjedhjet do të mbahen këtë të dielë (kjo pyetje u shtrohet në mënyrë standarde).

Partitë duhet të përcjellin jo vetëm shkallën e mbështetjes por edhe nivelin e mobilizimit në të cilin mund të llogarisin në ditën e zgjedhjeve. Subjektet që kanë votues më të afërt mund të llogarisin në dalje më të lartë.

Këtë kujdes duhet të kenë edhe kompanitë anketuese sepse niveli i mbështetjes domosdo duhet të analizohet duke marrë parasysh gatishmërinë për të dalë në zgjedhje. Një subjekt që në parim ka mbështetje më të lartë mund të del më keq në zgjedhje nëse ditën e zgjedhjeve një pjesë e votuesve më pak të motivuar nuk dalin fare.

Votuesit e AAK-së tregojnë se janë më besnikët ndaj partisë së tyre (91%), të pasuar nga ata të PDK-së (71%), VV (67%), ndërsa ata që e lidhin veten me LDK-në ndihen më së paku të afërt (56%).

Afërsia me partinë (2023, sipas gatishmërisë për të votuar për subjektin)



2. Sjellja e votuesve

Njerëzit i zgjedhin partitë për arsye të ndryshme dhe është e rëndësishme që partitë dhe aktivistët e demokracisë ta kuptojnë këtë dinamikë. D4D angazhohet që ta bëjë politikën më racionale dhe më pak emocionale, më shumë për politikën dhe më pak për karizmën individuale. D4D në mënyrë rutinore në anketat e opinionit publik, u kërkon respondentëve të deklarojnë se cila është arsyeja se pse ata e zgjedhin partinë e tyre të preferuar.

Krahasuar me vitin 2012, sot më shumë votues e zgjedhin partinë e tyre të preferuar bazuar në afinitetin e tyre për liderët. Rritja e Vetëvendosjes duket se ka rritur shkallën që respondentët e zgjedhin partinë për shkak të liderit (34% në vitin 2023, krahasuar me 27%, njëmbëdhjetë vjet më parë).


Numri i atyre që e zgjedhin partinë e tyre të preferuar politike për shkak të interesit kombëtar të Kosovës ka rënë ndjeshëm nga 26% në 16% aktualisht. Respondentët që vlerësojnë cilësinë e programit të partisë si të rëndësishme po ashtu ka rënë me 5%, ndërsa numri i atyre që e vlerësojnë cilësinë e ekipit dhe të listës së kandidatëve është rritur disi, ashtu sikurse numri i atyre që preferojnë ta shohin rajonin e tyre të përfaqësuar më mirë. Kjo na bën të vijnë në përfundim se politika ka të bëjë më tepër me personalitetet e përfshira dhe më pak për çështje dhe programe, gjë që është një trend negativ.

Krahasimi i rezultateteve sipas gjinisë jep dallimin kryesor në dy variabla – 22% e burrave e shohin cilësinë e ekipit si të rëndësishme, krahasuar me 15% të grave. Anasjelltas, grave më shumë sesa burrave, u pëlqejnë partitë që angazhohen për interesin kombëtar të Kosovës, që mund të jetë edhe për faktin se gratë përfitojnë më pak nga interesat klienteliste.

2.1. Dalja në zgjedhje këtë të dielë

Rreth 58% të respondentëve deklarohen se gjithsesi do të votonin po të mbaheshin zgjedhjet këtë të dielë dhe trendi është më i lartë tek burrat (2/3) sesa tek gratë (rreth gjysma) edhe pse pjesa e mbetur e grave thonë që dalin por nuk janë të sigurtë.


A do të votonit nëse do të mbaheshin zgjedhje të parakohshme parlamentare? (2023)



Gratë akoma votojnë në shkallë më të ulët sesa burrat, edhe pse hendeuku është zvogëluar me kohë, siç paraqet grafikoni më poshtë.

Votuesit nga zonat rurale deklarohen më të sigurtë që do të votojnë (59% prej tyre) përderisa tek kategoritë e përgjigjeve tjera është njësoj. Të moshuarit janë votues më të zellshëm dhe afër 70% prej tyre janë të sigurtë që do të votonin dhe trendi i kundërt përcjellet ngjashëm tek moshat më të reja.


A do të votonit nëse zgjedhjet mbahen të dielën? (2023, sipas gjinisë)



Partitë që dëshirojnë të rrisin elektoratin normalisht duhet të targetojnë të rinjtë sepse ata votojnë më pak dhe e kanë votën më pak të përkushtuar për një subjekt të caktuar. Por njëkohësisht kjo kategori nuk voton në numër të lartë dhe i duhet dhënë shkas të fuqishëm për t'i motivuar për të votuar në ditën e zgjedhjeve.


Trendi sipas arsimit është i butë dhe votuesit e arsimuar kanë tendencë lehtësisht më të lartë për të votuar. Sa i përket profesionit, dy kategoritë me dalje më të ulët janë të papunësuarit, të punësuarit në sektorin publik, studentët dhe amviset.

A do të votonit nëse zgjedhjet mbahen të dielën? (2023)



2.2. Arsyet për përzgjedhjen e partisë


Arsyet e votimit të partisë politike



Respondentët rural priren ta shohin liderin si më të rëndësishëm se sa respondentët urban (35% kundrejt 32%). Respondentët urban vlerësojnë më tepër cilësinë e ekipit (22% kundrejt 16%). Duhet të pritet që votuesit rural të

kujdesen që ta shohin rajonin e tyre të përfaqësuar (10% kundrejt 8% për respondentët urban) dhe 8% e tyre priren të zgjedhin partinë nëse njohin dikë atje (krahasuar me 5% për votuesit urban).

Arsyet e votimit të partisë politike (2023, sipas moshës)



Grup mosha më e re duket të jetë më patriotikja (interesi i Kosovës), grup mosha 25-34 vlerëson cilësinë e programit dhe respondentët e moshës së mesme shfaqin interes për cilësinë e ekipit, përderisa të moshuarit e shohin liderin si më të rëndësishmin.


Respondentët me më pak arsimim priren ta shohin liderin si më të rëndësishmin (38%), përderisa ata me shkollë të mesme ose të lartë e shohin cilësinë e ekipit si më të rëndësishme. Ata me arsim universitar e shohin interesin e Kosovës si arsye më të rëndësishme se pse ata mbështesin një parti politike.

	< Mesme	Mesme	> Mesme
Për liderin	41%	37%	24%
Për cilësinë e ekipit	8%	8%	9%
Për cilësinë e programit	11%	11%	12%
Për angazhimet për interes të Kosovës	18%	12%	23%
Sepse jam anëtar i asaj partie	0%	2%	1%
Sepse kjo parti ka listën më të mirë të kandidatëve	7%	12%	9%
Njoh dikënd në atë parti	4%	4%	4%
Kam anëtar të familjes në atë parti	3%	3%	3%
Partia përfaqëson interesat e rajonit tim	6%	9%	12%
Nuk di/ refuzoj	3%	1%	2%

Është interesante se edhe respondentët me arsim të lartë kërkojnë që partia e tyre e preferuar të angazhohet për interesat e rajonit prej nga ata vijnë (12%, gati sa dyfishi i atyre që kanë më pak arsimim).


Edhe kosovarët me të ardhura më të larta priren ta shohin liderin si më pak të rëndësishëm dhe u kushtojnë rëndësi më të madhe tipareve të tjera krahasuar me ata që kanë të ardhura më pak se mesatarja.

Arsyeja e votimit në vitin 2021 (2023, sipas të të ardhurave)



Shumica e votuesve të LVV dhe AAK kanë përzgjedhur këtë subjekt për shkak të liderit. Votuesit e PDK mbështesin subjektin e tyre për shkak të cilësisë së ekipit përderisa LDK-ja përzgjedhet për shkak të cilësisë së programit. AAK-së dhe PDK-së u besohet më tepër për ata që dëshirojnë që rajoni i tyre të përfaqësohet përderisa LVV dhe LDK kanë mbështetjet më të shpërndarë.

Arsyeja e votimit në zgjedhjet e radhës (2023)



Grafikoni më lartë shpjegon arsyet pse mbështetësit e tyre i përzgjedhin dhe ofron informatë se ku mund të përmirësohen.

Transicioni i lidërshiptit në të cilin kalojnë PDK dhe LDK më tepër vërehet tek LDK ku përqindja e respođentëve që përzgjedhin këtë parti për shkak të liderit është më e ulëta. Arsyet për votim për LDK-në janë më të shpërndara dhe lehtësisht dominon përzgjedhja për shkak të programit dhe për shkak se respođentët njohin dikend.

PDK përzgjedhet për shkak të ekipit dhe përfaqësimit rajonal. Përveç për liderin, votuesit e AAK-së votojnë këtë parti sepse njohin dikend aty dhe për shkak se vlerësojnë se rajoni i tyre përfaqësohet.

LDK dhe PDK duhet të investojnë në paraqitje ekipore dhe programore por edhe AAK dhe LVV nuk duhet të mbështeten vetëm tek graviteti i liderëve por duhet të investojnë më tepër në ekip dhe në pozicione tematike.


2.3. Përzgjedhja e kandidatëve

Përveç pyetjes për shkaqet pse qytetarët përzgjedhin një subjekt, anketa ka pyetur edhe për kriteret si kanë zgjedhur kandidatët brenda subjektit. Respođentët deklarohen se më së shumti preferojnë kandidatët e dëshmuar profesionalisht (28%) dhe pse kjo ka shënuar rënie nga 36% sa ishte në vitin 2012.

Kandidatët e qytetit të vet përzgjedhen nga 20% të qytetarëve, pasuar nga ata që zgjedhin kandidatët që njohin personalisht (14%). Kandidatët e afërt me liderin apo të sugjeruar nga partia preferohen nga 9% të qytetarëve dhe ata të dëshmuar gjatë luftës gjithashtu nga 9% (çuditërisht me trend të rritjes). Mbështetja për liderin dhe për këto tri kategori të njohjes personale dëshmon për një rritje të personalizimit të politikës

ku qytetarët shohin më pak arsye programore dhe më tepër arsye personale për preferencë.

Në zgjedhjet e kaluara kam votuar për kandidatët..



Solidariteti mes grave për të votuar një grua tjetër ka qenë shkas për përzgjedhje tek çdo e pesta grua dhe me siguri se


.....

është njëra nga arsyet pse është rritur numri i grave që është zgjedhur në Kuvendin e Kosovës.


Në vitin 2012, 23% të qytetarëve kishin deklaruar se shpejtë e shpejtë kanë përzgjedhur 5 emra në fletëvotim, por kjo ka rënë në 2% tani (kryesisht për të rinjtë), që shënon përmirësim dhe kujdes më të madh në përzgjedhje.

Grafikoni më poshtë paraqet edhe arsyet për përzgjedhje të kandidatëve varësisht nga vendbanimi. Votuesit urban kërkojnë dëshmi profesionale përderisa votuesit rural mbështesin kandidatët që janë nga vendbanimi i tyre.

Vota për kandidatët (2023, sipas vendbanimit)



Vota për kandidatët (2023, sipas grupmoshës)



Mosha rinore ka tendencë që shpejtë të përzgjedhin 5 emra (që është dukuri edhe tek votuesit me më pak arsim). Mosha e mesme (45-54) vazhdon të zgjedhë kandidatët që janë dëshmuar gjatë luftës (që gjithashtu mbështeten më tepër nga respondentët me nivel më të ulët arsimor). Trendet tjera mund të vërehen në grafikon.

Votuesit më pak të arsimuar duket të jenë më lokalistë ku 21-22% të atyre me shkollë të mesme ose më pak preferojnë kandidatë nga qyteti i vet, krahasuar me 16% të votuese më të arsimuar.

Vota për kandidatët (2023, sipas nivelit të edukimit)

	< mesme	mesme	> mesme
dëshmuar profesionalisht	9%	26%	15%
nga qyteti im	6%	22%	8%
që i njoh	3%	14%	7%
afër liderit	2%	9%	5%
dëshmuar në luftë	4%	7%	4%
religjionit tim	2%	8%	5%
tjetër	4%	11%	6%

**pyetje me përgjigje të shumëfishta.*

Respondentët me të ardhura më pak se mesatarja preferojnë kandidatë të dëshmuar profesionalisht (31% krahasuar me 26% për ata me të ardhura më pak se mesatarja). Për kandidatë të cilët i njohin personalisht votojnë vetëm 10% të atyre nën mesatare, krahasuar me 18% të atyre me të ardhura mbi 300 Euro.

Në kros-tabulimin e arsyeve për përzgjedhje të kandidatëve me afërsinë partiake, mund të vërehen disa trende të lehta.

Vota për kandidatët <i>(sipas afërsisë me partinë politike të preferuar)</i>	Afërt	Jo i afërt
dëshmuar profesionalisht	29%	31%
qyteti im	20%	22%
i njoh	16%	10%
afër liderit	10%	7%
dëshmuar në luftë	9%	7%
religjionit tim	8%	9%
gjinisë time	4%	10%
tjetër	4%	5%


Se gratë ndjehen më pak të afërta me subjektin konfirmohet edhe këtu ku 2/5 votojnë për gjininë e njëjtë dhe më pak e respektojnë sugjerimin e liderit për kandidatët sesa meshkujt.

Mbase ky diskutim është i rëndësishëm për subjektet politike kur të vendosin radhitjen e kandidatëve. Çdo parti duhet të zhvillojë anketa dhe fokus grupe për nevoja të veta zgjedhore dhe mund të testojë më detajisht imazhin dhe besimin tek kategori të ndryshme demografike të qytetarëve.

2.4. Burimi i informacionit


Burimi i informacionit është i rëndësishëm dhe ky është një nga trendet kryesore që ka ndryshuar me kohë. Në anketën e fundit më 2023, 41% të respondentëve janë informuar nga interneti, rritje e ndjeshme nga vitet paraprake. Në vitin 2012, shumica e qytetarëve informoheshin nga gazetat (87%), radio (1%) dhe miqtë e familja (1%), e tanimë edhe televizionit ka filluar t'i bie rëndësia në favor të internetit.

Burimi i informacionit ndër vite




Gratë informohen më shumë nga televizioni sesa meshkujt (30% krahasuar me 27%) dhe më pak shfrytëzojnë internetin për t'u informuar. Sa i përket vendbanimit, trendi është më i theksuar ku 2/3 e qytetarëve të zonave rurale varen nga televizioni, krahasuar me zonat urbane ku nga TV informohen pak më shumë se gjysma. Analiza e mostrës për moshë zbulon trend edhe më të theksuar ku grupmoshat mbi 35 vjeç përcjellin më tepër televizionin për informata përdërisa grupmoshat më të reja mbështeten në internet.

Burimi i informacionit (2023, sipas grupmoshës)




Respondentët më të arsimuar (që kanë më shumë se shkollën e mesme të kryer) kanë tendencë të informohen më tepër nga interneti, përderisa ata me më pak se shkollë të mesme pothuajse tërësisht varen nga TV (80%).

Burimi i informacionit (2023, sipas të nivelit të edukimit)



Trend të ngjashëm nxjerr kros-tabulimi në bazë të të ardhurave ku ata që fitojnë më tepër sesa 300 euro mbështeten më tepër në internet, përderisa më të varfërit mbështeten në TV.

Burimi i informacionit (2023, sipas të të ardhurave)




Të rinjtë, të arsimuarit, të pasurit dhe popullata urbane më tepër mbështeten në internet krahasuar me kategoritë tjera që mbështeten në TV.

Kjo informatë mund t'u hyjë në punë subjekteve politike gjatë fushatës që të shfrytëzojnë mjetet që u duhen kur të targetojnë popullatën që e kanë në cak. Kjo e gjetur mund të

jetë e dobishme për kandidatë të pavarur dhe kandidatë për deputetë që nuk kanë mbështetje nga subjekti sepse fushata në internet kushton më pak sesa ajo në televizion.

Trendi gjithashtu është krahasuar me përgjigjet se për kë kanë votuar në zgjedhjet e fundit të përgjithshme më 2021. Votuesit e VV kanë pasur tendencë që të informohen nga televizioni dhe i njëjti trend vlen edhe për PDK dhe LDK por në shkallë më të ulët. Respondentët me afërsi me AAK kanë deklaruar se informohen më tepër nga interneti.


Burimi i informacionit (2023, sipas votave për vitin 2021)



Ata që shikojnë televizion janë votues që votojnë më tepër për liderin. Mbase kjo është e natyrshme duke pasur parasysh që televizioni kryesisht është medium nacional dhe ekspozimi aty krijon mbështetje të shpërndarë në tërë vendin. Ata që kanë interesa më të përqendruara lokalisht (shih dy kolonat e

fundit “njoh dikend ...” dhe “... interesat e rajonit tim”) mbështeten më tepër në informata nga interneti.


Vota për partinë politike (2023, sipas burimit të informacionit)




Grafikoni më poshtë paraqet kryqëzim të të njëjtës përgjigje varësisht si respondentët bëjnë përzgjedhjen e kandidatëve.

Respondentët që informatat marrin nga interneti kanë tendencë më të ulët për të votuar.

A do të votonin qytetarët këtë të dielë? (2023, sipas burimit të informacionit)



Vota për kandidatët (2023, sipas burimit të informacionit)




3. Trendet e votimit

Pjesa më kontraverse e çdo ankete është trendi i votimit për partitë politike. Kjo anketë del disa muaj pas përfundimit të anketës (qershor 2023) sepse nuk ka për qëllim të ndikojë në disponimin votues por të ekzaminojë shkaktarët e disponimit. Kemi bërë pyetjen se për kë do të votoje, jo për shkak që të matet disponimi që të krijohet lajm por për arsye për të bërë kros-tabulimet e shumta që kemi në punim ashtu që të kuptojmë dinamikën e shkaqeve dhe nuancave që ndikojnë në përfaqësim më cilësor. Për partitë mund të jetë primare shkalla e mbështetjes dhe dihet se zhvillojnë anketa të tilla më shpesh sesa ne. D4D zbrërthen këtë në segmente më specifike për të studiuar forcat prapa trendeve.


3.1. Për kë do të votoje po të mbaheshin zgjedhjet këtë dielë?

LVV mbetet subjekti i preferuar më tepër në zona urbane, që deri diku vlen edhe për LDK-në përderisa PDK dhe AAK gëzojnë më tepër mbështetje në zona rurale. Gjatë rritjes së vet, LVV është mbështetur tek votuesit gra dhe tani kjo ka ndryshuar pak

Votimi këtë të dielë (2023, sipas gjinisë)




Votimi këtë të dielë (2023, sipas vendbanimit)




Sa i përket të të ardhurave, votuesit e LDK-së duket se kanë të ardhura më të larta.

Vota për partinë politike këtë të dielë (2023, sipas të të ardhurave)



Mbështetja për LVV rritet krahas me nivelin arsimor dhe një trend i ngjashëm vlen edhe për LDK-në. PDK gëzon mbështetje në mesin e qytetarëve me arsim mesatar përderisa AAK ka trend të kundërt me LVV dhe LDK-në dhe gëzon mbështetje tek qytetarët më pak të arsimuar.

Vota për partinë politike këtë të dielë (2023, sipas nivelit të edukimit)



VV mbështetet më shumë nga moshat e reja dhe më pak nga moshat e mesme.

Vota për partinë politike këtë të dielë (2023, sipas grupmoshës)




Tabela më poshtë paraqet motivin e respondentëve si të përzgjedhin kandidatët, varësisht se cilës parti i përkasin. Gjatë përzgjedhjes së kandidatëve, votuesit e LVV dhe LDK kanë tendencë më të lartë për të votuar kandidatët profesionalisht të dëshmuar.


Respondentët që votojnë kandidatët e dëshmuar gjatë luftës më së shumti vijnë nga radhët e PDK dhe AAK. Votuesit e afërt me PDK kanë tendencë të votojnë siç u sugjerohet nga lideri apo partia.

Respondentët që votojnë politikanët që i njohin personalisht më së shumti i takojnë AAK ndërsa ata që shpejti i rumbullakësojnë 5 emra kanë tendencë të jenë më shumë në mesin e LDK.

Vota për kandidatët (Sipas preferencës politike)	LVV	PDK	LDK	AAK
Kandidatët nga qyteti juaj	22%	19%	22%	23%
Kandidatët e moshës tuaj	4%	2%	3%	1%
Kandidatët të cilën i njoh personalisht	13%	10%	15%	20%
Kandidatët e gjinisë time	7%	4%	5%	5%
Kandidatët të afërt me liderin apo të sugjeruar nga partia	9%	10%	8%	5%
Kandidatët e dëshmuar profesionalisht	33%	21%	31%	22%
Kandidatët e dëshmuar gjatë luftës	3%	21%	4%	16%
Kandidatët që i përkasin religjionit tim	7%	13%	6%	8%
I kam zgjedhur shumë shpejtë 5 numra	3%	1%	5%	1%
Tjetër (specifiko)	0%	0%	1%	0%

Si do të dukej shpërndarja e ulëseve në Kuvendin e Kosovës nëse hipotetikusht do të përcaktohej nga zgjedhjet në datën që është bërë anketa? Në grafikoni më poshtë LVV është vendosur në pjesën e majtë të gjysëm-pites si parti me orientim ideologjik të majtë. Në pjesën e djathtë janë vendosur partitë më të djathta dhe në mes janë vendosur partitë që janë vlerësuar me polarizim më të ulët me LVV, dtth që mund të jenë në kombinatorikë për koalicion qeveritar.

Si do të dukej Kuvendi i Kosovës sipas vullnetit politik bazuar në anketën e realizuar në qershor 2023?



Po të mbaheshin zgjedhjet në qershor të 2023 kur është realizuar anketa, VV do të fitonte 44% të votës dhe kur të hiqen preferencat e respondentëve (nuk di apo refuzoj), kjo do të përkthehej në 54 ulëse në Kuvend. Për të bërë qeveri do t'i duhej një parti më e vogël dhe përfaqësuesit e pakicave joserbe.


3.2. Nga viti 2021 deri më 2023?

Tek kategoria e qytetarëve të papunësuar dhe të punësuar në sektor publik (tri rreshtat e parë) ka rritje të besimit tek LVV dhe PDK dhe rënie tek të tjerët. Pensionistët kanë shënuar rënie të besimit tek LVV dhe LDK përderisa amviset kanë shënuar besim në rritje tek PDK dhe AAK. Studentët kanë shënuar rënie të besimit tek të gjitha partitë përveç LDK-së.

Ndryshimi për mbështetjen për subjektet politike nga 2021-2023 varësisht nga statusi i punësimit				
	LVV	PDK	LDK	AAK
I papunësuar – kërkon punë	↑	↑	↓	↓
I papunësuar – nuk kërkon punë	↑	↑	↓	=
I punësuar në sektorin publik	↑	↑	↓	=
I punësuar në sektorin privat	=	=	=	=
I punësuar kohë pas kohe	↑	↓	↓	↑
Pensionist	↑	=	↓	=
Amvise		↑	=	↑
Student/ nxënës	↓	↓	↑	↓


Krahasimi i përgjigjeve për kend kanë votuar më 2021 (zgjedhje nacionale) dhe si do të votonin këtë të dielë po të kishte zgjedhje nxjerrë disa trende interesante. LVV ka rënie të besimit tek burrat (nga viti 2021), përderisa PDK shënon rënie të besimit tek gratë dhe shënon rritje tek burrat. LDK ka shënuar rritje të lehtë tek të dy gjinitë.

Dallimi nga 2021 dhe për kë do të votonin këtë të dielë (2023, sipas gjinisë)




Ngjashëm është matur trendi i ndryshimit nga 2021 deri më 2023 sa i përket lokalitetit dhe LVV shënon rënie të ndjeshme tek popullata rurale dhe rritje tek ajo urbane, ngjashëm si edhe AAK.

Dallimi nga 2021 dhe për kë do të votonin këtë të dielë (2023, sipas vendbanimit)



Grafikoni në faqen tjetër tregon trendin tek moshat e ndryshme për secilin subjekt. LDK ka rritje të besimit tek mosha e shtyrë dhe duket si pasqyrë e kundërt e trendit tek PDK. LVV ka rritje tek mosha më e re por rënie tek grupmoshat tjera.

Dallimi nga 2021 dhe për kë do të votonin këtë të dielë (2023, sipas grupmoshës)




3.3. Preferenca e dytë

Përveç pranueshmërisë së përgjithshme, indikator i rëndësishëm është edhe pranueshmëria në mesin e mbështetësve të partive tjera. Nëse një qytetar humb besimin tek partia vet për çfarëdo arsye, gjasat janë që lëviz tek partia e dytë për të cilën ka simpati. Gjithashtu, në raste kur komunat shkojnë në raund të dytë për të përzgjedhur kryetarin e komunës në balotazh, shpesh është vendimtar popullariteti në mesin e votuesve të partive tjera.

Kjo pyetje është e kufizuar sa mund të përdoret dhe vërehet një trend i pasigurisë dhe hezitimit për përgjigje. Më tepër se gjysma e respondentëve (gati 2/3 tek burrat) janë deklaruar se nuk dijnë, refuzojnë të përgjigjen apo nuk kanë zgjedhje të dytë (shtylla e fundit).

Nëse partia juaj e preferuar nuk do të garante, cila do të ishte zgjidhja juaj e dytë? (2023, sipas gjinisë)



Kjo pyetje është bërë edhe në anketat e viteve paraprake dhe është interesante të përcjellet trendi kohor. LVV ka rënë si përzgjedhje e dytë, mbase normale për shkak se është rritur si përzgjedhje e parë.

LDK është rritur si alternativë e dytë më lartë sesa kurdoherë më parë (14%). PDK kishte rënë si përzgjedhje e dytë më 2019 por është rikthyer në nivelin më të lartë që ka pasur në të kaluarën (8%). AAK ka rënë si përzgjedhje alternative në 4%.


Përzgjedhja e LDK-së si zgjedhje e dytë e preferuar është më e theksuar tek grupmoshat mbi 45 vjeç, tek PDK tek mosha e mesme, dhe tek VV për moshat e reja.

Fakti se gratë kanë përzgjedhje të dytë më shpesh se burrat tutje dëshmon se janë votues më fleksibil dhe më pak të parapërcaktuara.


Dy grafikonet më poshtë paraqesin trendin e preferencave të dyta nga viti 2012 deri tani. Në faqen tjetër paraqitet trendi në përgjithësi dhe në faqen pasuese paraqitet trendi për grupmosha të ndryshme.

Për shkak të shkallës së lartë të refuzimit të përgjigjes për këtë pyetje, margjina e gabimit është rritur dhe përgjigjet duhet marrë si orientuese.

Nëse partia e juaj e zgjedhur nuk do të garonte, cila do të ishte zgjedhja e juaj e dytë?



Nëse partia juaj e preferuar nuk do të garonte, cila do të ishte zgjidhja juaj e dytë? (2023, sipas grupmoshës)



Në tabelën më poshtë paraqitet mbështetja e secilit subjekt në mesin e fansave të partive tjera. Shumica e votuesve të LVV si subjekt të dytin kanë LDK-në (44%), pasuar nga subjektet tjera (24%), PDK (10%) dhe AAK (8%). Trendi vlen edhe anasjelltas ku për 42% të votuesve të LDK-së, LVV është

opsioni i dytë, pasuar nga PDK të cilën do t'a zgjidhnin 36% të votuesve të LDK-së si zgjedhje të dytë dhe 12% për AAK.

Qershor 2023		Për kë do të votonit këtë të dielë dhe preference e dytë nëse partia e preferuar nuk do të garonte?				
		LVV	PDK	LDK	AAK	Tjerë
Për kë do të votonit këtë të dielë?	LVV		10%	44%	8%	24%
	PDK	16%		27%	21%	18%
	LDK	42%	36%		12%	1%
	AAK	19%	30%	35%		8%
	Tjerë	31%	14%	10%	1%	38%

LDK është gjithashtu opsioni i dytë edhe për 27% të votuesve të PDK të cilët si opsion të tretë kanë AAK (21%), tjerët (18% dhe LVV (16%). Edhe për votues të AAK, LDK mbetet opsioni i dytë i preferuar (për 35%), pasuar nga 30% që do të mbeshtesnin PDK dhe 19% për LVV.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”



Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup i analistëve që po brengoseshin gjithnjë e më shumë që procesi i shtetndërtimit e kishte lënë anash demokracinë. Vizioni i D4D-së është të promovojë një qytetari aktive dhe të arsimuar, e cila merr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe e përdor arenën publike për përfaqësim dhe vendim-marrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e resurseve që janë efikase, të shpejta, afatgjate dhe që sjellin zhvillim të barabartë. D4D ndikon në politikat specifike, promovon një qasje ndërsektoriale për zgjidhjen e problemeve dhe trajton rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime në rritje dhe operon me efektivitet maksimal në mënyrë që të promovojë plotësisht stabilizimin e Kosovës dhe zhvillimin demokratik.

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së, ju lutemi vizitoni faqen tonë elektronike: **www.d4d-ks.org**

Ky publikim është përkrahur nga:

